

Crna Gora - Mali i Zi, Opština Tuzi - Komuna e Tuzit
DOO "KOMUNALNO" - SHPK "KOMUNALE"

Broj 448/22

Tuzi-Tuz, 08.04.2022 god.



**DOO KOMUNALNO TUZI
SHPK KOMUNALE TUZ**

RAPORTI VJETOR

**MBI REALIZIMIN E PORGRAMIT VJETOR TË
KRYERJES SË VEPRIMTARIVE KOMUNALE PËR
VITIN 2021**



MARS, 2022

Përmbajtja e pjesës programore të Raportit mbi realizimin e programit vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale:

I	Hyrje
II	Të dhënat themelore mbi kryerësin e veprimtarive komunale (shtojca 2 pika 5 e Rregullores)
III	Kapacitetet për kryerjen e veprimtarive Komunale <ul style="list-style-type: none"> ➤ Burimet njerëzore ➤ Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës Komunale ➤ Paisjet dhe mjetet transportuese (shtojca 2 pika 4 e Rregullores)
IV	Objektivat (realizimi nga programi për vitin 2021)
V	Bazat për zhvillimin e Programit (Shtojca 2 pika 6 e Rregullores)
VI	Realizimi i programit vjetor për kryerjen e veprimtarive Komunale në pjesën e (fushës) fizike të veprimtarive (Shtojca 2 pika 7 e Rregullores)
VII	Realizimi i Programit vjetor të kryerjes së veprimtarive komunale në pjesën e treguesëve financiarë – realizimi i planit financiar (Shtojca 2 pika 8 e Rregullores)
VIII	Raporti mbi pyetjet lidhur me politikën e pagave dhe punësimit (Shtojca 2 pika 9 e Rregullores)
IX	Borxhet (Shtojca 2 pika 10 e Rregullores)
X	Realizimi i Planit të Prokurorit public (Shtojca 2 pika 11 e Rregullores)
XI	Politika e çmimeve (Shtojca 2 pika 11 e Rregullores)
XII	Vlerësimi i situatës dhe rezultateve të arritura

VËREJTJE: Përmbajtja e raportit mbi realizimin e programit për kryerjen e veprimtarive Komunale është në përputhje me dispozitat e nenit 26 pika 3 dhe 4 të Ligjit mbi veprimtaritë Komunale (“Fl. Zyrtare e Malit të Zi nr. 055/16, 074/16, 002/18 dhe 066/19) dhe shtojcës nr.2 të Rregullores mbi përmbajtjen e detajuar të kryerjes së veprimtarive Komunale dhe raporti vjetor për realizimin e programit vjetor të kryerjes së veprimtarive Komunale (“Fleta Zyrtare e MZ” nr. 54/20 nga data 08.06.2020

I HYRJE

Përgaditja e raportit për realizimin e programit për kryerjen e veprimtarive komunale për vitin 2021, është përcaktuar nga dispozita e nenit 26, alineja 3 dhe 4 dhe nenit 29 pika 7 e Ligjit mbi veprimtaritë komunale (“Fl. Zyrtare MZ” nr. 055/2016, 074/16, 002/18 dhe 066/19).

Raporti mbi kryerjen e veprimtarive komunale në vitin 2021 janë të bazuara në analizat e realizimit të programit të definuar për kryerjen e veprimtarive komunale SH.P.K. “Komunalno/Komunale” Tuz, për vitin 2021.

Raporti punohet në bazë të programit për kryerjen e veprimtarive komunale për vitin 2021, i cili është konsideruar dhe në të cilën është dhënë pëlqimi nga Kuvendi i Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – rregullore komunale”, nr. 048/20 nga data 31.12.2020).

Gjithashtu duhet përmendur se pritshmëritë nga SH.P.K. „Komunalno/Komunale“ Tuz, me formimin e Shoqërisë, kanë qënë të mëdhaja nga fillimi i punës së vet, megjithatë procesi i ndarjes së bilancit nga kryeqyteti nuk ka rrjedhur me dinamikën e planifikuar, kështu që veprimtaritë komunale të caktuara dhe të kontraktuara, Shoqëria nuk ka qënë në mundësi t’i realizojë duke marrë parasysh mungesën në pjesën e mbushjes së mjeteve të materiale teknike të nevojshme dhe punëtorëve në pjesën operative të Shoqërisë.

Bazat e raportit dhe vlerësimi i treguesve individualë mbi realizimin e programit për kryerjen e veprimtarive komunale për vitin 2021, është bazuar në të dhënat e programit të përcaktuar, si dhe të dhënave mbi realizimin e të gjithë shërbimeve dhe njësisive të punës të shoqërisë afariste, të cilat janë parashikuar të formohen, por deri te ajo nuk ka ardhur për shkak të problemeve të lartpërmendura.

Me program është përcaktuar mirëmbajtja e hapësirave publike, grumbullimi, heqja dhe deponimi i mbetjeve, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëra publike, mirëmbajtja e ndriçimit publik, shërbimet e tregut, funksionimi i azilit për qej, mirëmbajtja e lumejve dhe burimeve, si dhe punët e jashtëzakonshme të mirëmbajtjes së rrugëve gjatë dimrit, rregullimi i sinjaleve vertikale dhe horizontale dhe puneve të tjera.

Realizimi dhe vëllimi i operacioneve financiare të përpunuara janë në kapitullin VI të këtij

Raporiti, në pajtim me rregulloret ligjore, si shtojcë e rregullores janë dhënë pasqyrat financiare të Shoqërisë (Bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit).

Financimi i programit tonë është bërë përmes mjeteve nga buxheti i Komunës së Tuzit dhe mjeteve të veta të shoqërisë nga pagesa e shërbimeve të kryera.

Shoqëria gjatë vitit 2021, ka arritur të mbajë kualitet të mirë të punës me kompetencat e veta, pagesën e rregullt të punëtorëve, investimet në materiale për paisje dhe automjeteve harmonishëm me mundësitë dhe kapacitetet e veta.

Pamundësia e mbledhjes dhe heqjes së mbetjeve që nuk janë mbetje komunale, si dhe jodefinimi i lokacioneve për deponimin e mbetjeve ndërtimore dhe asaj të gjelbër nga ana e organit kompetent të themeluesit, ka mbetur problem edhe në vitin 2021, edhe kundër disa përpjekjeve të vetëqeverisjes lokale që ta zgjedh këtë problem, gjë që shoqërisë sonë afariste ia ka komplikuar në një masë të madhe mundësinë e menaxhimit cilësor të këtyre mbetjeve.

Problem i veçantë jo vetëm për komunën tonë, por si në të gjithë teritorin e Malit të Zi paraqet problemi i grumbullimit, heqjes dhe menaxhimit të autogomave të prishura. Për shkak të kësaj situatë nuk kemi qënë në gjendje të pengojmë rritje e këtyre llojeve të mbetjeve përreth lokacionit të kontenjerëve.

Pasi që ministria gjegjëse ka rekomanduar që këtë menaxhim ta bëjë deponia sanitare “Livade”, gjatë vitit 2021 nuk ka përfunduar procedura e ndërtimit të objektit në lokalitetin e përmendur si dhe sistemi qendror për tërë rajonin e Malit të Zi. Është për tu pritur që ky problem të zgjidhet në mënyrë afatgjate në vitin e ardhshëm dhe për këtë duhet paraparë mjetet financiare për menaxhimin e këtyre llojeve mbetjeve.

II Të dhënat kryesore për Kryerësin e veprimtarive komunale

Nr.	TË DHËNAT KRYESORE PËR KRYERËSIN E VEPRIMTARIVE KOMUNALE	
1.	Të dhënat kryesore të identifikimit: <ul style="list-style-type: none"> ▪ emërtimi ▪ selia ▪ të dhënat mbi themeluesin ▪ NIPT ▪ TVSH 	SH.P.K. „KOMUNALNO/KOMUNALE“ TUZ Rruga nr. pn, 81206 TUZ Kuvendi I Komunës Tuz 03283135 33/31-00037-9
2.	Forma e organizimit	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
3.	Aktet themeluese	Vëndimi KK TUZ. („Fleta Zyrtare e MZ – dispozitat komunale“ numri 033/19)
4.	Çështjet e statusit juridik	Shoqëri e pavarur një-antarshe themelues i së cilës është Kuvendi I Komunës së Tuzit. Shoqëria afariste operon me asete në pronësi të shtetit
5.	Struktura e pronësisë	Komuna e Tuzit 100%
6.	Organizimi I brendshëm (skema organizative – shtesa me tabelë)	Akti mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin numër: 01/19-01 od 09.10.2019
7.	Aktivitet Kryesore	Aktiviteti kryesor: 3900 Pastrimi i mjedisit jetësor dhe aktiviteteve tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave
8.	Organi I menaxhimit dhe drejtimit	Bordi i Drejtoreve: <ul style="list-style-type: none"> • Nikolla Sinishtaj, Kryetari • Anton Lulgjuraj, anëtar • Elma Drešević, anëtare Drejtori Ekzekutiv: <ul style="list-style-type: none"> • Nikolla Camaj
9.	Të dhëna tjera specifike për kryerësin e shërbimeve komunale	Kontakt + 382 (0)67 073295 Web sajt: www.komunalno-tz.me e-mail: info@komunalno-tz.me Vendimi për regjistrim në CRPS, nr. 5-0905198/001 nga data 08.10. 2019.

TABELA (të parapara me nenin 4, shtojcë e Rregullores)

Statuti i SH.P.K. "Komunalno/Komunale" Tuz përcakton që organet e Shoqërisë janë: Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Ekzekutiv.

Si pjesë organizative janë të përapara sektori për punë të përgjithshme e të përbashkëta dhe veprimtarive komunale brenda të cilave janë organizuar pjesë më të vogla organizative.

Sektorin për veprimtaritë komunale e përbëjnë:

- Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimi
- Shërbimi i pastrimit
- Shërbimi i ndriçimit publik
- Shërbimi për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, tregjeve dhe hapësirave tjera publike
- Shërbimi i tregut, parkimit, garazhit dhe stacionit të autobusëve

Punëve të përgjithshme dhe të përbashkëta:

- Shërbimi i punëve financiare dhe komerciale dhe
- Shërbimi i punëve të përgjithshme dhe juridike

E bazuar në nenin 9 të Statutit të Shoqërisë, Shoqërisë i është besuar kryerja e veprimtarive Komunale të mëposhtme:

- Mbledhja mbeturinave të parrezikshëme, si aktivitete dominante, në Ligjin për Klasifikimin e aktiviteteve të përcaktuara në sektorin E, zona 38, dega 38.1, grupi 38.11
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave publike
- Mbledhja, transporti dhe deponimi i mbeturinave komunale për nevoja të shfrytëzuesve të shërbimeve dhe
- Mbledhja dhe tregtimi i lëndëve sekondare

Shoqëria kryen veprimtari komunale, të parashikuara me Ligjin për klasifikimin e veprimtarive ("Fleta Zyrtare e MZ", numri 18/11) si veprimtari kryesore si më poshtë:

36 –Grumbullimi, pastrimi dhe furnizimi me ujë,

37 –Largimi i ujërave të zeza,

38.11, 38,21, 38,32 –ripërdorimi i materialeve mbetëse,

39 –Pastrimi i mjedisit dhe aktivitete të tjera në lidhje me menaxhimin e mbeturinave,

81,3 –Shërbimi i mirëmbajtjes

Veprimtaritë nga paragrafi 1 i këtij neni janë veprimtari me interes publik.

III Kapacitetet e ekzekutorëve të veprimtarive komunale

Burimet njerëzore

Kur është fjala për kapacitetin e burimeve njerëzore në dispozicion të Shoqërisë, ato janë të pamjaftueshme. Duke parë plotësimin e vendeve të lira të punës dhe nevojave të Shoqërisë, situata

aktuale është shumë e kufizuar. Nevojat në vitin 2021 tregojnë qartë nevojën për punësimin e fuqisë puntore, veçanërisht në pjesën operative të Shoqërisë. Parakushti themelor për një zgjidhje cilësore të kësaj çështje është rregullimi i problemeve me Kryeqytetin, marrja e punëtorëve dhe mbushja e sektorëve dhe shërbimeve. Për një strukturë të detajuar mbi të punësuarit dhe politikave të punësimit, shikoni Kapitullin VIII të të ardhurave dhe politikës së punësimit.

Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale

Selia e Shoqërisë gjindet në qendër të qytetit të Tuzit, e cila është marrë me qira, dhe dhe e cila do të përdoret deri në një lajmërim të mëtejshëm. Gjitashtu posedon një magazin të vogël për pajisje dhe rekvizita, si dhe hapësirën për parkimin e automjeteve speciale dhe makinerive të punës, që gjithashtu është marrë me qera.

Paisjet dhe Mjetet transportuese

Shoqëria, nga paisjet posedon një sharrë elektrike me zinxhir të markës Stihl, 1 sharrë për prerje të gjelbërimit, 10 kosa shpine, një kositës dore dhe një ventilator për gjethe. Për sa i përket mjeteve transportuese, Shoqëria aktualisht posedon një makinë për mbeturina të markës Volvo I cili është blerë me para të donacionit nga SHBA, makina për plehra e cila është fituar si donacion nga ana e "TIKA"-s si dhe një kamion I markës Mercedes dhe dy traktorë.

Nga investimet në paisje, Shoqëria gjatë vitit 2021 ka investuar në makinë që kanë qenë më të nevojshmet për Shoqërinë e kjo është makinë speciale për grumbullimin dhe bartjen e mbetjeve Komunale (makinë plehrash) me shumë prej 24,197.00

IV OBJEKTIVAT

OBJEKTIVAT THEMELORE (vlerësimi i punës)

1. Përfundimi i procesit të formimit të një kompanie dhe mbushja e saj me burime njerëzore, pajisje dhe automjetet e nevojshme.

Në fund të viti 2021, ka ardhur deri tek ndryshimet në strukturë dhe sistematizimin e shoqërisë, shoqëria ka fituar një formë të re, ku në përbërjen e shoqërisë nuk është më pjesë e saj Ujësjiellësi dhe kanalizimi dhe as Tregjet. Shoqëria po përgaditej të merrte përsipër të gjitha punët e parapara, megjithatë themeluesi e konsideroi se është më mirë që të vijë deri te formimi i dy shoqërive të reja.

2. Vendndodhjet për akomodimin dhe vënien në funksion të pjesës tekniko-operative të Shoqërisë janë të rregulluara ashtu që për zyra dhe për akomodim të makinerive të punës dhe automjeteve, paguhet qeraja.
3. Bilanci i ndarjes me shoqërinë afariste komunale të kryeqytetit të Podgoricës është përfunduar pjesërisht.
4. Formimi i sektorëve dhe shërbimeve në bazë të akteve mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, me rëndësi në pjesën operative të Shoqërisë.

Me formimin e shoqërive të reja nga fundi I vitit 2021 ndryshohet koncepti i shoqërisë, gjegjësisht struktura organizative e brendshme

5. Është vendosur një system kualitativ, funksional dhe i qendrueshëm për veprimtaritë Komunale në të gjithë teritorin e komunës së Tuzit.
6. Është ruajtur likuiditeti aktual i Shoqërisë dhe është vendosur një sistem kualitativ i kontabilitetit financiar dhe sistemi i pagesës së shërbimeve Komunale të ofruara, për persona juridic dhe fizik në zonën e komunës së Tuzit.
- 7.
8. Procedura e hartimit të akteve interne, në përputhje me Ligjin për punë, Ligjin për kontabilitet, Ligjin mbi veprimtaritë Komunale, Ligjin për ujërat, ligjin për mbetje dhe Ligjit mbi kujdesin e shëndetësisë në punë si ligje sistematike bazë është pjesërisht i realizuar.
9. Mirëmbajtja dhe punë e pandalshme në komunikacion me themeluesin, me shfrytëzuesit e shërbimit, organet shtetërore, në punët publike të shoqatës.

V BAZAT PËR HARTIMIN E PROGRAMIT

Kryerja e veprimtarive komunale si dhe afarizmi i Shoqërisë në vitin 2021 janë kryer duke zbatuar rregulloret themelore ligjore dhe vëndimin e vetëqeverisjes lokale:

Rregulloret themelore ligjore:

- Ligji mbi Shoqëritë («Fleta Zyrtare e MZ» numri 065/20)
- Ligji për punën («Sl.list CG» br.074/19)
- Ligji mbi veprimtari komunale («Fleta Zyrtare e MZ» numri 055/16,074/16,002/18,066/19)
- Ligji mbi Menaxhimin e mbeturinave («Fleta Zyrtare e MZ» numri 064/11 i 039/16)
- Ligji mbi vetëqeverisje lokale («Fleta Zyrtare e MZ » numri 002/18)
- Ligji për mbrojtjen e mjedisin jetësor («Fleta Zyrtare e MZ» numri 052/16)
- Ligji mbi mbrojtjen e natyrës («Fleta Zyrtare e MZ» numri 054/16)
- Ligji mbi prokurimet publike («Fleta Zyrtare e MZ» numri 074/19)
- Ligji mbi mbrojtjen dhe shëndetin në punë («Fleta Zyrtare e MZ» numri 034/14 i 044/18)
- Ligji mbi të ardhurat e punëtorëve në sektorin publik («Fleta Zyrtare e MZ» numri 016/16, 083/16,021/17, 042/17 i 012/18)
- Ligji mbi mbrojtjen e konsumatorit («Fleta Zyrtare e MZ » numri 002/14, 006/14, 043/15 i 070/17)
- Ligji mbi mbrojtjen dhe strehimin e kafshëve («Fleta Zyrtare e MZ» numri 14/08)

Aktet dhe rregulloret themelore komunale

- Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Komunalno/Komunale“ Tuz („Fleta Zyrtare e MZ – rregullore komunale „ nr. 033/19 nga data 14.08.2019.)

	Punët administrative teknike	6	4		2					6
	Punët kontabiliste dhe financiare	5	3							5
	Punët juridike	2	2							2
Veprimtaria kryesore	Njësia organizative I	3			2	1				3
	Njësia organizative II	11			7	1	3			11
	Njësia organizative III	3						3		3
	Njësia organizative IV									
	Njësia organizative ...									
	Njësia organizative N									
	Totali (I-N)	17			9	2	3	3		17
	Mirëmbajtja									
	Veprimtaritë shtesë									
	Punët logjike 2	2			2					2
	Totali	34	11		13	2	3	3		34

SHËRBIMI I PASTRIMIT

Dispozitat e Nenit 19 të ligjit mbi veprimtaritë komunale (Fleta Zyrtare e Malit të Zi« numri 055/16,074/16,002/18,066/19) dhe neneve 9 dhe 10 të vendimit për rendin komunal (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – rregullore komunale”, nr. 033/19 nga data 14.08.2019), si dhe me nenin 9 të Statutit të SHPK "Komunalno / Komunle" Tuz, kuvendi Komunal i Tuzit, (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – rregullore komunale”, nr. 039/19 nga data 24.09.2019), përshkruajnë detyrimin për të hequr dhe asgjësuar mbeturinat shtëpiake dhe këtu konsiderohen të gjitha mbeturinat e ngurta të krijuara në ndërtesat e banimit familjar dhe ambientet e biznesit, të cilat për nga madhësia e tyre mund të hidhen në kontejnerë të mbeturinave shtëpiake - kontejnerë si dhe materiale të djegura-hirit).

Mardhëniet me shfrytëzuesin janë themeluar me:

KATEGORIA	NUMRI I SHFRYTËZUESVE
Amviseri	2661
Afaristët, institucionet dhe sipërmarrësit	229

Detyrat e ruajtjes së pastërtisë të hapësirave publike dhe bartjes së mbetjeve komunale nga ato zona kryhen nga "Komunalno / Komunale" Tuzi, kurse detyrat e ruajtjes së pastërtisë në zona të tjera kryhen nga persona juridikë dhe fizikë që administrojnë ose përdorin ato zona. Bartjen e mbetjeve për këta persona kryhet nga Shoqëria në bazë të faturave, gjegjësisht kontratave.

Nga programi i vitit 2021 parashikohet mirëmbajtja, pastrimi ,dhe pastaj dinamikën dhe mënyrën e ruajtjes së pastërtisë publike, largimin dhe deponimin e mbetjeve komunale dhe mbetjeve të mëdha nga zona e qytetit dhe periferisë që përmban shumën e përafërt të fondeve për zbatimin e këtij programi. Siç ka qenë planifikuar, bartja e mbetjeve kryhet në deponinë sanitare "Livade". Bashkëpunimi u krijua me një marrëveshje ku fatura i dorëzohet Shoqërisë sonë në fund të çdo muaji. Bartja e mbeturinave ndjek dinamikën e parashikuar. Qendra e qytetit dy herë në ditë, vendbanimet një herë në ditë, ndërsa personat juridikë shkon me ftesën e tyre ose sipas nevojës. Pastrimi i mbetjeve të mëdha kryhet çdo ditë ose sipas nevojës.

Dinamika e mirëmbajtjes së hapësirave publike në regjimin e verës dhe dimrit sigurohet plotësisht, si dhe për të gjitha manifestimet e mëdha dhe festat fetare.

Frekuenca e pastrimit të zonave publike në pjesën e qendrës së qytetit sigurohet duke punësuar 2 punëtorë në zona publike në regjimin jashtë sezonit, dhe 3 punëtorë në qendër të qytetit gjatë periudhës së verës së vitit 2021. Për mirëmbajtjen e hapësirave publike në periferi dhe zonat rurale, janë angazhuar 17 punëtorë që vazhdimisht ruajnë pastërtinë, si dhe zonat e gjelbra publike.

Mirëmbajtja mekanike e hapësirave publike u krye në përputhje me kërkesat e policisë komunale dhe nevojave të treguara për shkak të hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve nga qytetarët, të ftuarit dhe subjekteve të biznesit.

Pastrimi i rrugëve përfshin: grumbullimin manual të mbeturinave, mbledhjen dhe mbetjeve me një automjet të veçantë, heqjen dhe deponimin e mbetjeve komunale, dhe mbetjeve të tjera natyrore dhe artificiale. (heqja e pjesëve të mobiljeve të hedhura,degë, rrënoja, etj.)

- **Pastrimi dhe mirëmbajtja manuale e hapësirave publike në teritorin e Komunës së Tuzit**

Rajonet	NJ.M	Sipërfaqja
1.Vuksanlekaj Rr. 1	m ²	750
2.Tuzi Rr. 3	m ²	3645
3.Tuzi Rr. 2	m ²	2340
4.Tuzi Rr. 1	m ²	1902
5.Tuzi Rr. 12	m ²	1161
6.Parku i Tuzit	m ²	2565
Totali	m²	12363

ZONA1

Rruga	Ditë pune
1.Vuksanlekaj Rr. 1	48
2.Tuzi Rr. 3	48
3.Tuzi Rr. 2	325
4.Tuzi Rr. 1	325
5.Tuzi Rr. 12	325
6.Parku i Tuzit	325


Java e punës në sektorin e Pastërtisë për për boshatisjen e kontenjerëve është 6 ditë, (ajo është nga e Hëna-Shtunë), kurse për pastrimin e mbetjeve të mëdha dhe deponisë së egër gjatë ditëve të punës (ajo është e Hënë-Premte)

Për nevojat e grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbetjeve janë të angazhuara dy makinë plehrash të markave “Volvo” dhe “BMC Tugra” të cilat janë fituar si donacion. Gjithashtu makineritë që janë ceduar me kontratë nga ana e SHPK “Cistoca” Podgorice, “Makina për plehra Mercedes Axor”, “Traktori me karrocier”, “Skip makina e punës MTZ”, “Kamion me kiperkafje FAP”, “Automjet udhëtimi Volkswagen Caddy” të cilat kanë mundur mirëmbajtje të pastërtisë më të mirë dhe më të lehtë në teritorin e komunës sonë.

Shoqëria gjithashtu ka zavrëndësuar 40 V=1 të reja, 1 m³ komtenjerë si dhe 1 kontenjer V=5m³ të cilat i kemi shpërndarë në pjesët e ngushta të qytetit.

Gjatë periudhës së verës rregullisht kemi mirëmbajtur dhe pastruar pikat turistike të cilat janë me vlerë të madhe për qytetarët, siç janë: Vitoja, Tergaja, Rakiq, si dhe selitë nën Deçiq.

Totali që është deponuar në deponinë Livade është 3,841,880 ton mbetje Komunale, të cilat janë deponuar nga muaji janar i vitit 2021 deri në dhjetor të vitit 2021.



Grafiku 1. Përmbledhja e mbetjeve komunale në deponinë sanitare „Livade“

SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE LOKALE, VARREZAVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE

Shërbimi i mirëmbajtjes së rrugëve lokale, varrezave dhe hapësirave publike, ka bërë punët në mirëmbajtjen dhe rregullimin e zonave të gjelbërta publike përmes mirëmbajtjes së pemëve,

gardheve, lëndinave, krasitjeve, hapjen e gropave, mbrojtjes dhe përpunimit të fidanëve, kositjes manuale dhe mekanike të zonave, si dhe largimi i mbetjeve nga zonat e gjelbërta.

Zonat e gjelbërta që mirëmbahen rregullisht nga ky shërbim janë:

- Parku në qendër të qytetit
- Gjëlberimi në hapësirën e QIK “Malësia”
- Gjëlberimi në hapësirën e Komunës së Tuzit
- Shtrati i lumit Urrela
- Burimi Vitoja
- Burimi Krevenica
- Gjëlberimi në hapësirën mbas klubit të penzionerëve
- Këndet e lojrave për fëmijë në Milesh, Sukruq, Nënhelm

Në vitin 2021 janë realizuar punimet e peisazhit, restaurimi dhe kujdesi i lëndës bimore, të kositurit e rregullt të barit, fshirja e rrugëve, mirëmbajtja e pemëve dhe shkurreve, mbjellja e luleve sezonale, shkurreve dhe fidanëve të tjerë. Kositja e barit në parkun e Tuzit, te Komuna, QIK Malësija kryhet 3 herë në muaj në periudhën e vegjetacionit dhe një here në muaj gjatë muajve të tjerë me mbledhjen dhe bartjen e mbetjeve. Kositja e zona të tjera të gjelbra publike bëhet sipas nevojës psh. 3 x në vjet.

➤ **Mirëmbajtja e varrezave**

Gjatë vitit 2021 veçanarisht në pranverë dhe vjeshtë në sipërfaqet e varrezave prej 140000m² në teritorin e komunës së Tuzit është kryer kositja e barit, heqja e rrënjëve të këqija dhe të bimëve të tjera.

Për vitin 2021 janë realizuar me shumë punë se vëllimi i planifikuar, e i referohen aktiviteteve të përforcuara për kositjen e varrezave.

Nr	Vendi	m ²
1	Varrezat në KK Tuz	48 000
2	Varrezat në KK Grudë	1000
3	Varrezat në KK Hot	18 000
4	Varrezat në KK Vrane- Vlanë	20 000
5	Varrezat në KK Triesh	13 000
6	Varrezat në KK Dinoshë	26 000
7	Varrezat në fshatin Kojë	2 000
8	Varrezat në KK Vuksanlekaj	12 000
	Totali	140 000

➤ **Mirëmbajtja e vazhdueshme e rrugëve**

Për nevojat e mirëmbajtjes së vazhdueshme, sipas rregullores është e paraparë kositja, prerja e shkurreve dhe bimëve tjera, grumbullimi dhe bartja e materialeve të grumbulluara.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar punët e kositjes së brezave rrugor, prerja e shkurreve dhe bimëve të tjera, heqja manuale e rrëshqitjeve të dheut në zonat malore në rrugë, sipas specifikimit të mëposhtëm:

Kositja:

Rajoni	Verës	Dimrit
Nënhelm Rruga 2	2	1

Dreshaj Rruga 1	2	1
Nënhelm Rr. 1	2	1
Koderbudan Rr. 1	2	1
Koderbudan - Sukruq	2	1
Koderbudan - Sukruq	2	1
Vuksanaj Rr. 5	2	1
Vuksanaj Rr. 3	2	1
Vuksanaj Rr. 4	2	1
Sukruq Rr. 1	2	1
Sukruq Rr. 2	2	1
Sukruq Rr. 3	2	1
Sukruq Rr. 5	2	1
Sukruq Rr. 7	2	1
Sukruq Rr. 8	2	1
Vlane Rr. 5	2	1
Qendra BL Vrane - Zbeq	2	1
Tuz Rr. 5	2	1
Tuz Rr. 7	2	1
Tuz Rr. 8	2	1
Tuz Rr. 15	2	1
Tuz Rr. 16	2	1
Tuz Rr. 30	2	1
Tuz Rr. 31	2	1
Dushiq Rr. 1	2	1
Dushiq Rr. 3	2	1
Shipshanik Rr. 1	2	1
Shipshanik Rr. 2	2	1
Shipshanik Rr. 3	2	1
Shipshanik Rr. 4	2	1
Shipshanik Rr 5	2	1
Shipshanik Rr 6	2	1
Shipshanik Rr 10	2	1
Shipshanik Rr 11	2	1
Dheu I Zi Rr. 1	2	1
Dheu I Zi Rr. 3	2	1
Dheu I Zi Rr. 14	2	1
Rogath Rr. 4	2	1
Rogath Rr. 3	2	1
Mileshi I Poshtëm 5	2	1
Milesh I Poshtëm 4	2	1

Mileshe I Poshtëm 1	2	1
Mileshe I epërm 1	2	1
Planic Rr. 1	2	1
Dinosha Rr. 1	2	1
Omerbozhaj Rr. 1	2	1
Omerbozhaj Rr. 2	2	1

Tkurrje:

Rajoni	Verës	Dimrit
Mileshe - Këshev- Kurrec	2	1
Dinoshe – Mjegotin	2	1
Dinoshe – Pikale - Selisht	2	1
Ranza e Qafes - Traboin	2	1
Drume Rr. 1	2	1
Drume Rr. 2	2	1
Drume - Bardhaj	2	1
Fudna – Trieshe – Poprat	2	1


VII REALIZIMI I PLANIT FINANCIAR

Shoqëria operoi pozitivisht në vitin 2021, me rezultat veprimtarie prej + 98.726,85€.

	2020	2021	Index %
Të ardhurat nga veprimtaria	253.167,28	629.283,88	59.77
Shpenzimet nga veprimtaria	245.188,65	530.557,03	53.79
Rezultati	+ 7.978,63	+98.726,85	12,37

Rezultatet krahasuese të punës të viti 2020-2021

Rezultati i punës për vitin 2021



Realizimi i faturuar

Viti 2021	Faturuar	Paguar	Indexi i realizimit
Amvisëri	147,556.29	129,520.47	0.88
Ndërmarrjet	259,918.68	235,457.92	0.905
TOTALI	407,474.97	364,978.39	0.895

TË ARDHURAT – PARAQITJA ANALITIKE

Të ardhurat e ndërmarrjes	Viti 2020	Viti 2021	Indexi
Të ardhurat nga buxheti komunal	120.000,00	200,000.00	1,67
Te ardhurat nga mbledhja e shërbimeve të amvisërive	38.705,07	142,831.00	3,69
Të ardhurat nga mbledhja e pagesave për shërbimet ndaj personave juridikë	68.094,00	285,662.00	4,20
Të ardhurat nga Tregu I Gjellbër	998,34	13360.76	13,38
Të ardhurat tjera	25.369,87	790.00	0,03
TOTALI	253.167,28	642,643.76	2,54

SHPEZIMET – PARAQITJA ANALITIKE

(A)

Pagat	Viti2020	Viti 2021	Indexi
Neto pagat	126,859.48	244,142.75	1,92
Taksat dhe kontributet nga fitimi dhe në paga	34,430.77	91,789.35	2,67
Pagesat ditore dhe udhëtimet zyrtare	3,097.37	1,582.81	0,51
TOTALI	164,387.62	337,514.91	2,05

(B)

Shpenzimet materiale dhe të tjera	Viti 2020	Viti 2021	Indeksi
Shpenzimet materiale	8,107.49	4,550.21	0,56
Shpenzimet e shërbimeve joproduhuese	22,083.25	54,165.28	2,45
Karburant dhe lubrifikant	6,417.64	22,571.46	3,52
Shpenzimet e energjisë elektrike	184.62	4,476.94	24,25
Shpenzimet e shërbimeve PTT	1,647.40	3,487.17	2,12
Shpenzimet e shërbimeve komunale - ujë	123.43	2,438.50	19,76
Premitë dhe sigurimet	594.92	498.96	0,84
Shërbimet bankare dhe pagesat	611.76	1,065.58	1,74
Shpenzimet e kontabilitetit, auditimit, këshillimit dhe shërbimeve të tjera intelektuale të personave juridikë	2,820.07	500.00	0,18
Shpenzimet tjera	5,869.77	5,654.26	0,96
Shpenzimet e deponimit sanitarë	30,203.06	91,092.57	3,02
TOTALI	78,663.41	190,500.93	2,42

(C)

AMORTIZIMI	2,137.62	5,139.60	2,40
-------------------	-----------------	-----------------	-------------

TOTALI (A) + (B) + (C)	Viti 2020	Viti 2021	Indeksi
Pagat	164,387.62	337,514.91	2,05
Materiale dhe shpenzimet tjera	78,663.41	190,500.93	2,42
Amortizimi	2,137.62	5,139.60	2,40
TOTALI	245,188.65	533,155.44	2,17

Analiza e kreditueshmërisë – Z-score

Pranë modeleve të shumta të cilat përdoren në kushtet e sotme të punës për vlerësimin e kreditueshmërisë dhe parashikimi e besueshmërisë të subjekteve ekonomike që gjinden në parafalimentim, në praktikën tonë më së shpeshti i pranueshëm është modeli Altmanov Z- score. Në bazë të përshtatjes me modelin origjinal i cili ka qenë aplikueshëm vetëm për subjektet ekonomike aksionet e të cilit tregtohen në tregun e organizuar, u krijua një model i modifikuar i zbatueshëm për subjekte ekonomike aksionet e të cilit nuk tregtohen në tregun e organizuar. Modeli Altmanov sot është model përgjithësisht i pranueshëm i cili shërben për parashikimin e falimentimit për subjektet ekonomike. Bazohet në analizen e bilansit të subjekteve ekonomike.

Egzistojnë 3 vargje të vlerave në të cilat subjektet ekonomike klasifikohen:

- Suksesshëm Z-score >2,99
- Rrezikshëm 1,82 < Z-score < 2,99
- Para falimentimit Z-score < 1,82

Nr.	NGA BILANCI	Viti 2021
1	ASETET TOTALE	197,855
2	MJETET RRJEDHËSE	165,099
3	IMOVINA (Nekretnine, postrojenja, oprema i biološka sredstva) PRONAT (Pasuritë e padundshme, bimët, paisjet dhe burimet biologjike)	32,756
4	KAPITALI I KTHYESHËM	165,099
5	X1 (4/1)	0.83
6	Fitimi ose humbja e pashpërdarë	91,921
7	X2 (6/1)	0.46
8	Rezultatet nga punësimi i rregullt para tatimit	98,726
9	X3 (8/1)	0.50
10	Kapitali	91,920
11	Detyrimet afatgjata	0
12	X4 (10/11)	0
13	Të ardhurat nga shitja	428,493
14	X5 (13/1)	2.17

Z-SCORE 5.46

Formula për llogaritje e Z-score = $1,2X1 + 1,4X2 + 3,3X3 + 0,6X4 + 1,0X5$

Llogaritja për vitin 2021 $1,00 + 0,65 + 0,00 + 2,17 = 5.46$

Në bazë të rezultatit mund të përmbylim se Z-score është më i madh se 2.99 dhe se shoqëria punon suksesshëm.

VIII RAPORTI MBI ÇËSHTJET QË LIDHEN ME POLITIKËN E PAGAVE

Duke marrë parasysh që Shoqëria është e sapoformuar dhe në periudhën e kaluar, për shkak të arsyeve objektive, për shkak të bilancit të pazgjidhur të ndarjes me ndërmarrjet komunale nga Podgorica, nuk ishte e mundur të përmbushen të gjithë sektorët dhe shërbimet. Shoqëria gjatë vitit 2021, në përputhje me dinamikën e punës dhe detyrimeve, ka punësuar burime njerëzore dhe kuadër, në përputhje me kapacitetet nga Rregullorja mbi organizimin dhe sistematizimin e brendshëm.

Tabela 1

LLOJI I PUNËS	Të punësuarit në vitin e	Niveli i kualifikimit								Total
		VI ili VII 1 ose më	V	IV 1	IV2	III	II	I1 ose I2	të tjerë	
Punët drejtuese-udhëheqëse	2	7		1						8
Punët administrativo-teknike	7	4		6						10

Punët kontabiliste dhe financiare	5	5									5
Punët juridike	2	3									3
Veprimtaria kryesore	Njësia organizative I	7			3				3	5	11
	Njësia organizative II	5			5			1			6
	Njësia organizative III	2			2						2
	Njësia organizative IV	1			1				1		2
	Njësia organizative ...										
	Njësia organizative N										
	Totali (I-N)	14			11				5	5	21
Mirëmbajtja											
Veprimtaria shtesë											
Punët logjike 2	2							2			2
TOTALI	33	19		18				7	5	49	

Tabela 2

LLOJI I PUNËS	MOSHA						Vitet shërbim					
	18-25	26-35	36-45	46-55	56-65	Mbi 65	Deri 5	6-10	11-15	16-25	26-35	Mbi 35
Upravljačko - rukovodstveni poslovi		4		1	2	1	3	2			3	
Punët administrativo-teknike		7	2		1		8	2				
Punët kontabiliste dhe financiare		4			1		4					1
Punët juridike	1	2					3					
Aktivitet kryesore	5	4	5	5	2		19		1	1		
Mirëmbajtja			1	1			2					
Veprimtaritë shtesë												
Punët Logjike												
TOTALI	6	21	8	7	6	1	39	4	1	1	3	1

Tabela 3

LLOJI I PUNËS	Numri i të punësuarve sipas muajve të vitin për të cilin bëhet raporti											
	JAN	SHK	MARS	PRILL	MAJ	QER	KORR	GUSH	SHTA	TET	NEN	DHJE
Punët Adinistrative dhe teknike				1			1	5				
Punët kontabiliste dhe financiare	1			1				3				
Punët juridike							1	1				
Veprimtaritë kryesore				1				4		4	6	
Mirëmbajtja									1	1		
Veprimtaria e shtuar												
Punët logjike												
TOTALI	1			3			2	13		5	7	

IX BORRHET DHE OBLIGIMET

NR.	Qellimi Lloji i detyrimit	Shuma e detyrimit	Periudha Afatet	Të shlyera deri më 31.12.2020.	Obligimet Në vitin 2021
1.	Detyrimet afatshkurte në 31.12.2021	36.869,12 €		0	36.869,12 €
2.	Kreditë afatshkurte dhe afatgjata	0		0	0
3.	Obligimet dhe vendimet tatimore	0		0	0
4.	Detyrime për taksat dhe kontribute për vitin 2021	23.474,00 €		0	23.474,00 €
5.	Detyrime për deponimin e mbetjeve në deponinë „Livade“	67,735.88 €		0	67,735.88 €
TOTALI		128.079,00 €			128.079,00 €

Siç shifet në tabelën e paraqitur më lart niveli i detyrimeve dhe borxheve është i lartë, se Shoqëria, përballet me një periudhë jashtëzakonisht të vështirë të ruajtjes së likuiditetit aktual, veçanërisht në fushën e detyrimeve financiare afatshkurtra dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore. Duhet të theksohet se në fillim të vitit 2021, kemi shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet, si dhe një pjesë të detyrimeve afatshkurtra në të cilat përfshihen edhe furnizuesit. Borxhet ndaj “Deponisë” Podgorica në fund të vitit 2021 jsnë në shumën prej 67,735.88 €.

X ZBATIMI I PLANIT TË RPOKURORIMIT PUBLIK

Plani i Prokurorimit Publik i SH.P.K. “Komunalno/Komunale” Tuz për vitin 2021 i cili është miratuar më 29.01.2021 kishte vlerë prej **158.049,00€**. Plani është ndryshuar dhe plotësuar 3 herë gjatë vitit 2021, e gjitha në pajtim me LPP-në.

2021	<i>Plani I Prokurorimit Publik (29.01.2021)</i>	<i>I Ndryshimi (09.04.2021)</i>	<i>II Ndryshimi (03.08.2021)</i>	<i>III Ndryshimi (30.08.2021)</i>
Mallrat	88.799,00 €	78.799,00 €	55.799,00 €	61.799,00 €
Punët	50.400,00 €	70.200,00 €	56.200,00 €	63.885,00 €
Shërbimet	18.850,00 €	23.850,00 €	23.850,00 €	18.850,00 €
UKUPNO:	158.049,00 €	172.849,00 €	135.849,00 €	144.534,00 €

Burimet e shpenzuara gjatë vitit 2021

Mallrat: **36.180,04 EUR**

Punët: **20.000,00 EUR**

Shërbimet: **35.905,06 EUR**

Shkalla e realizimit të planifikimit/realizimit është 58,81%.

XI POLITIKA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Shoqëria në ditën 31.12.2021 ka pasur:

- 2525 përdorues nga kategoria e personave fizikë - amvisëri
- 225 përdorues nga kategoria e personave juridikë

Lista e Çmimeve të shërbimeve është definuar dhe miratuar me vendimin e organeve të menaxhimit në të cilë i është dhënë pëlqimi nga Kuvendi i Komunës së Tuzit, (“Fleta Zyrtare e MZ - rregullore Komunale” nr. 034/20). Lista e çmimeve aktuale e Shoqërisë, janë të harmonizuara me koficientet më të ulëta të çmimeve për shërbimet Komunale në rajonin qendror të Malit të Zi. Lista e çmimeve është në përdorim nga tetori i vitit 2020 dhe në bazë të të njëjtës, është parë një shkallë e rritjes të së ardhurave në Shoqëri, e cila deri atëherë ka funksionuar në varësi të donacioneve dhe transferëve nga Komuna e Tuzit. Në pajtim me Ligjin mbi veprimtaritë komunale, nga Prilli i vitit 2022 do të aplikohet Lista e çmimeve në pajtim me Rregulloren e metodologjisë do të bëhet llogaritja e çmimeve të shërbimeve komunale, e cila është dorëzuar përmes Shoqatave të Shoqata e ndërmartjeve komunale në formë të propozimit të Ministrisë kompetente.

Duke marrë parasysh se Shoqëria është themeluar në fund të vitit 2019, dhe deri në nëntor të vitit 2020, nuk ka pasur të ardhura të veta, dhe se të gjitha të ardhurat e Shoqërisë kanë gjeneruar nga Komuna e Tuzit, nuk është mundur që në afatin e rregullt të sygjerojë një Listë çmimesh të re në pëputhje me Rregulloret e ligjeve dhe nenligjeve të reja.

Duke respektuar deklarinimin paraprak dhe në veçanti faktin se me 20 prill të viti 2020 është miratuar Rregullorja mbi çmimet të veprimtarive komunale, ishte për tu pritur se mënyra e llogaritjes së pagave për personat juridik dhe fizik do të mbahen me çmimet aktuale të shërbimeve.

Pagesa e shërbimeve

Kategoria e përdoruesve të shërbimeve	2021.g.%
Amvisëritë – personat fizik	88%
Persona juridic	90,5%
TOTALI	89,5%

XII VLERËSIMI I SITUATËS DHE REZULTATEVE TË ARRITURA

Problemet kryesore në veprimtaritë gjatë vitit 2020 bazohen në zgjidhjen e mjedisit të punës, që nënkuptohet krijimin e kushteve të punës, prokurimin e makinerive të nevojshme si dhe uljen e detyrimeve aktuale afatshkurtra, me nevojën për të ruajtur likuiditetin aktual dhe për të paguar pagat e punëtorëve. Gjithashtu, duhet përmedur se punësimi ka qënë shumë i vështirë për shkak të pandemisë korona virus, rritja e obligimeve afatshkurtëra, duke ruajtur likuiditetin aktual.

Mjetet e planifikuara për Shoqërinë tonë në formë të transferimeve nga buxheti i komunës së Tuzit në vlerë prej 200,000.00 €, të cilat sipas parashikimeve tona në atë periudhë ishin të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet për shkak të grumbullimit të shpenzimeve gjatë vitit 2020.

Si start-up Shoqëria, është e nevojshme të gjindet një model efikas funksionimi, kur kjo të realizohet atëherë ky model do të jetë edhe efektiv. Për tu arritur e lartëpërmendura, është e nevojshme që themeluesi në pajtim me nenin 14 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale të sigurojë kushtet e nevojshme, burimet financiare dhe materiale dhe tj. paisjet e nevojshme për kryerjen e punëve të cilat i janë besuar me kontratë mbi kryerjen e veprimtarive.

Kemi qenë të detyruar që shpenzimet e planifikuara me Programin e punës për vitin 2021, t'a reduktojmë në minimum, gjegjësisht të përshtaten me mjetet e parashikuara të Buxhetit të Themeluesit. Kjo pabarazi në mes të buxhetit dhe nevojave reale të mjeteve, nuk guxon të bëhet praktikë në të ardhmen, sepse me sjellje të tillë vazhdueshme do të tunden likuiditetet në periudhë afatgjatë. Shpenzimet në vitin 2021 kanë qenë të duplikuara në krahasim me vitin 2020, sepse ka ardhur deri tek rritja e vëllimit të punës, ka ardhur deri tek rritja e numrit të punësuarve, gjë që automatikisht i ka rritur shpenzimet tona.

Mosbalanci i lartëpërmendur i mjeteve të duhura dhe i programit financiar real dhe pagesa e ulët e shërbimeve të ofruara, kanë ndikuar në grumbullimin e borxheve ndaj furnitorëve (Kapitulli IX). Për shkak të ndarjes së parealizuar me Kryeqytetin, dhe për shkak të çmimit të lartë për deponimin e mbeturinave, Shoqërisë i vështirsohet ndjeshëm puna dhe funksionimi normal.

Investimet e planifikuara nga Programi i punës për vitin 2021 dhe letrave të shumta drejtuar Komunës në lidhje me realizimin e tyre, konsiderojmë se është e nevojshme të realizohen të paktën investime themelore dhe projekte sipas përmbajtjes së planifikuar në mënyrë që të sigurohet infrastruktura e nevojshme për kryerjen e veprimtarive komunale në Komunë.

Si pjesë e krijimit të kushteve të nevojshme për punën e ndërmarrjes së re, është e nevojshme që vitin e ardhshëm të zbatohet plotësisht kontrata mbi delegimin e kryerjes së veprimtarive komunale midis themeluesit dhe ndërmarrjes si një detyrim ligjor i vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjes I të cilës është edhe themelues dhe e cila kryen veprimtaritë komunale.

Sistemi i parregulluar i hedhjes së mbeturinave, veçanërisht për mbetjet ndërtimore dhe mbetjet e gjelbra, si dhe për mbetjet inerte, shkaktoi akumulimin e përkohshëm të këtyre llojeve të mbetjeve në vende publike, si rezultat i të cilave u detyruam të kryenim një numër aktiviteteve të sanimit të vendeve për hedhjen e mbetjeve.

Mospërputhja financiare midis nevojave të programit dhe mjeteve të siguruara për realizimin e tij në pjesën e shpenzimeve të përbashkëta komunale, dhe tashmë praktikë e vendosur e zvogëlimit të konsiderueshëm të mjeteve të alokuara sigurisht që ndikuan në shkallën e vëllimit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Vlerësimi i përgjithshëm i punës dhe realizimi i përmbajtjes së programit për vitin 2021 është i kënaqshëm dhe mund të vlerësohet si i mirë, me problemet themelore të lartëpërmendura në punë.

Shtojcë: Bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit për vitin 2021

Dorëzuar:

- Komuna e Tuzit – Kryetarit të Komunës dhe Sekretariatit për zhvillim ekonomik
- Anëtarëve të Bordit të drejtorëve
- Arkiva BD
- Arkiva a/a

DREJTORI EKSEKUTIV
NIKOLLA CAMAJ



